

## PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

-----

Sot pasdite (e premte, dt. 04) do të ketë reshje me intensitet të lartë në të gjithë vendin. Në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastër mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve.

## PARASHIKIMI METEO

-----

### RESHJET

Sot pasdite (e premte, dt.04) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Tiranë dhe Vlorë, reshje intensive në qarqet Lezhë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat dhe Gjirokastër, ndërsa në qarkun Korçë priten reshje mesatare deri lokalisht intensive (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në të gjitha qarqet reshjet priten të shoqërohen me shtrëngata.

Nesër (e shtunë, dt. 05) priten reshje të dobëta në të gjitha qarqet.

### TEMPERATURA

Nesër (e shtunë, dt. 05) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 16 / 22 °C

në vendet e ulëta: 14 / 23 °C

në vendet malore: 9 / 21 °C

### ERA

Sot pasdite (e premte, dt.04) dhe nesër (e shtunë, dt. 05) dhe era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, ndërsa në bregdet pritet të fryjë e fortë.

**NIVELET E RREZIKUT**

**S'KA RREZIK**

**I ULËT**

**I MODERUAR**

**I LARTË**

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (Bulletin on Natural Hazards)



































Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 278/ 2024, 04-10-2024


Parashikimi nga 04-10-2024, ora 12:00 deri 05-10-2024, ora 23:59.

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive					
DURRËS	S'KA RREZIK	intensive					
TIRANË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
ELBASAN	S'KA RREZIK	intensive					
FIER	S'KA RREZIK	intensive					
BERAT	S'KA RREZIK	intensive					
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
VLORË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	intensive					

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.



**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 04 – 05.**

**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**SIMBOLE**

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke